



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

**Kryetarja e Komunës**

**01nr \_\_\_\_\_**

**Dt: 21.09.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040, nenit 8,9, 10 dhe 16.1 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale dhe Përfundimit 01 nr. 06-54059-7/1 i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me dt:14.08.2015, me të cilin është aprovuar kërkesa e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për subvencionimin e sektorit të pemëtarisë dhe vreshtarisë në Komunën e Gjakovës me paketa të plastikës 20 kg, me dt: 21.09.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

**1.** Lejohet subvencionimi i projektit të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për mbështetje financiare të sektorit të pemëtarisë dhe vreshtarisë në Komunën e Gjakovës, për sigurimin dhe shpërndarjen e paketave plastike 20 kg, duke e mbështetur realizimin e këtij projekti me subvencione në vlerë prej 7,439.30 € .

**2.** Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që ta realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 7,439.30 € , nga mjetet e subvencioneve të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, me të cilat do të mundësohet realizimi i obligimeve të Komunës së Gjakovës sipas kontratës me operatorin ekonomik NSHT “Agrocelina” me seli në Xërxe të Komunës së Rahovecit, e evidentuar me nr. 090 e dt: 16.09.2015 dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e NTSH “Agrocelina” nr. 1505001001985385, Raiffeisen Bank .

**3.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

**4.** Vendimi iu dërgohet :

- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit

**Kryetarja e Komunës**

**Znj. Mimoza Kusari – Lila**